



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *K2/D8-10* Prot.
Nr. Dok. 201900704/10

Tiranë *03/06/2020*

Lënda : *Rekomandim për çregjistrimin e tre armëve "pistoleta" të regjistruara në sistemin "SIMA" në emër të shtetasit ****

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë

Sikurse ju kemi vënë në dijeni me shkresën nr. K2/D8-2 prot., datë 30.05.2019, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi *** me banim në Rr. "Don Bosko", Pall. 133, Ap. 8, Tiranë. Ankuesi shkruan se në datën 15.05.2019 është njoftuar verbalisht nga specialisti i policisë së zonës të Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë se në sistemin e regjistrimit të armëve "SIMA", ai rezultonte se është i pajisur me tre armë "pistoleta me ajër". Gjithashtu atij i është thënë se këto të dhëna janë referuar nga Komisarjati i Policisë nr. 4 Tiranë.

Pasi është informuar lidhur me këtë problem ankuesi është paraqitur në Komisarjatin e Policisë nr. 3 Tiranë dhe ka deklaruar se nuk ka blerë asnjë armë, sipas përcaktimit të bërë nga ligji nr. 74/2014 "Për armët" dhe se nuk e di se si është bërë ky gabim në sistem. Ndërkohë ai ka kërkuar informacion lidhur me dokumentacionin e depozituar për t'u pajisur me armë dhe për regjistrimin e tyre si dhe datën e regjistrimit, por nuk i është dhënë informacioni i kërkuar prej tij. Gjithashtu ai ka deklaruar se në muajin shkurt 2017 nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë, janë sekuestruar në mjediset e Postës Shqiptare, Zyra Tranzite Tiranë, një koli postare e dërguar në adresën e tij. Kolia në fjalë me nr. CP983426796HK, ardhur nga Hong Kongu, është hapur dhe sekuestruar pa urdhër të prokurorit, kjo referuar procesverbalit me datë 23.02.2017. Sipas tij, sekuestrimi i kolisë pa urdhër të prokurorit është bërë në kundërshtim me nenin 299 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në atë kohë. Në këtë koli kanë qënë tre imitime pistoletash, të cilat janë në përdorim të lirshëm dhe pa leje të organeve kompetente. Në vijim të ankesës ai përshkruan edhe tipet dhe karakteristikat e tyre.

Ankuesi pretendon se këto objekte janë regjistruar gabimisht ose qëllimisht në emër të tij si "pistoleta me ajër" në sistemin "SIMA", në kundërshtim me ligjin nr. 74/2014 dhe menjëherë pas sekuestrimit të bërë nga Komisarjati i Policisë nr. 4 Tiranë.

Në përfundim të kësaj ankesë ai kërkon që:

1. Të informohet se çfarë “pistoletash me ajër” janë regjistruar në emër të tij në sistemin “SIMA”, dokumentacioni mbi bazën e të cilit janë regjistruar dhe data e regjistrimit të tyre.

2. Dokumentin që përcakton llojin e armëve në fjalë dhe kategorinë përkatëse sipas ligjit nr. 74/2014 “Për armët”.

3. Nëse bëhet fjalë për imitimet të cilat kanë mbërritur me postë me kolinë me nr. CP983426796HK, a është bërë ndonjë ekspertim nga ekspert të fushës përkatëse për të vlerësuar nëse ato plotësojnë karakteristikat e armëve të parashikuara në ligjin nr. 74/2014.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisariati i Policisë nr. 4 Tiranë me shkresën nr. 3914/1 prot., datë 19.06.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se, nga verifikimet e bëra në sistemin “SIMA” nuk rezultoi që shtetasi ******* të jetë i regjistruar me asnjë lloj arme. Nga informacionet që ka ky komisarati rezultoi se ai ka blerë disa armë sportive jashtë vendit dhe është interesuar në momentin që është informuar se këto armë janë sekuestruar nga policia. Në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 123, datë 23.02.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 277, datë 29.05.2015”, pika 29, gërma “c”, çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të blejë armë pneumatike me ajër me saçma, me energji nën 7,5 J dhe armë për sinjalizimin me dritë dhe ato me zë. Këto armë blihen dhe mbahen nga persona fizikë dhe juridikë pa autorizim, me detyrimin për t’i regjistruar ato në Komisaratin e Policisë, brenda 5 ditëve nga data e blerjes. Shtetasi e blenë armën në dyqanet e armëve vetëm me kartën e identitetit dhe shitësi lëshon një dokument me të dhënat e armës me të cilën blerësi shoqëron armën deri në momentin e regjistrimit të saj. Më pas shitësi e dërgon me postë këtë armë në adresën e porositësit. Sapo këto pako apo koli postare kalojnë procesin e skanimit në pikat doganore të vendit tonë, në skaner shfaqen menjëherë imazhet e armës, për të cilën bëhen disa veprime të tjera nga specialistët përkatës për të saktësuar kategorinë e armës. Paket postare dërgohen në Qendrën e Tranzitit në Tiranë, e cila ndodhet në territorin e Komisaratis të Policisë nr. 4 Tiranë. Kjo qendër njofton komisaratin për këto lloj pakosh dhe nuk ia jep të interesuarit, me pretendimin se mund të jetë një armë zjarri. Pas njoftimit nga kjo qendër, shkon Specialisti i Hetimit të Krimeve dhe bën tërheqjen e pakove të bllokuara me qëllim vlerësimin e tyre, kryen veprimet e nevojshme dhe magazinimin e tyre si provë materiale. Kjo procedurë është kryer edhe në rastin e ankuesit, ku veprimet janë kryer nga Specialisti për Hetimin e Krimeve N/Komisar Artan Azizaj, i cili sapo ka tërhequr paket, i ka dërguar armët në Sektorin e Policisë Shkencore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, i cili bën ekspertimin e tyre. Ndërkohë OPGJ-ja ka bërë edhe referimin e materialeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për vlerësim. Organi i prokurorisë pas dërgimit të aktit të ekspertimit nga organi kompetent merr vendimin përkatës.

Së bashku me shpjegimet Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë na ka dërguar edhe dy procesverbale “Mbi ekzekutimin e urdhrin të prokurorit për kthimin e sendeve të sekuestruara”, të mbajtura në datat 25.04.2019 dhe 29.04.2019. Nga përmbajtja e tyre rezultoi se për materialet e referuara nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë ndaj ankuesit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mos fillimin e procedimit penal. Pas këtij qëndrimi të organit të prokurorisë dhe nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit, shtetasi ******* i janë dhënë armët që ka blerë jashtë vendit konkretisht tre pistoleta dhe një armë tjetër me gjatësi 82 cm.

Drejtorja Vendore e Policisë (DVP) Tiranë me shkresën nr. 3814/1 prot., datë 11.06.2019 na informoi se, shtetasi ******* i është kthyer përgjigje për ankesën e bërë me shkresën nr. 36/1 prot., datë 29.05.2019. Në këtë përgjigje ai është informuar se bazuar në ligjin nr. 74/2014 “Për armët” dhe Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.

123, datë 23.02.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, datë 29.05.2015 “Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim të subjekteve juridikë e fizikë”, pika 1.11, gërma “c”, e cila ndryshon pikën 29, armët me ajër të cilat disponon ankuesi hyjnë në grupin e armëve sportive, të cilat blihen pa autorizim, por duhet të regjistrohen në Komisaratin e Policisë dhe për këtë procedurë nuk ka asnjë lloj detyrimi financiar. Gjithashtu atij i është bërë e ditur edhe dokumentacioni që duhet për regjistrimin e tyre, si ai i blerjes nga subjekti i licencuar për tregëtim dhe letërnjoftimi i blerësit.

Ndërsa Komisarati i Policisë nr. 3 Tiranë me shkresën nr. 5787/1 prot., datë 27.08.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se, në sistemin “SIMA” janë regjistruar tre copë pistoleta me gaz me Kod. 140001 në ngarkim të shtetasit *** Këto armë janë bërë dalje nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë dhe janë bërë hyrje në Komisaratin e Policisë nr. 3 Tiranë, sipas dispozitave ligjore në fuqi, pasi ai është banor në territorin që mbulon ky komisarati.

Nga dokumentacioni që na ka sjellë ankuesi pas bërjes së ankesës rezulton se, pas referimit të materialeve procedurale të bëra nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka bërë regjistrimin e procedimeve penale nr. 1814, datë 07.03.2017 dhe nr. 1480, datë 19.02.2018 për veprën penale “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, e parashikuar nga neni 278/5 të Kodit Penal. Me vendimin e datës 12.03.2018 të dyja këto procedime penale janë bashkuar në një procedim dhe emërtuar me nr. 1814 i vitit 2018. Përveç disa veprimeve hetimore është bërë edhe ekspertimi teknik-balistik i armëve në fjalë.

Nga akti i ekspertimit teknik-balistik nr. 64, datë 09.03.2017 dhe nr. 335, datë 23.10.2017 ka rezultuar se”

“Tre pistoletat objekte ekspertimi në kuptimin e ligjit nr. 74/2014 nuk klasifikohen tek armët e zjarrit. Ato janë të fabrikuar të prodhimit tajvanëz, janë në gjendje të rregullt teknike. Për shkak të mungesës së municionit (sferave metalike apo plastike) si dhe mbushjes së krëhërave me gaz nuk u provua përshtatshmëria e tyre për qitje.

Tre armët objekt ekspertimi në kuptimin e ligjit nr. 74/2014, klasifikohen armë në bazë të nenit 3, pika 1 dhe citoj: ““Armë” konsiderohet çdo mjet ose vegël e përgatitur me qëllim që, nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së lëndëve shpërthyesë, elektricitetit, gazrave, të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete që shkaktojnë dëm fizik a psikologjik”.

Ndërsa nga akti i ekspertimit teknik-balistik nr. 2385, datë 28.02.2018 i objektit të ekspertimit, një kuti postare ku brenda saj ndodhen pjesë arme të vendosura sipas formës së niesëve të armës në material polisterol me gjyrë të bardhë, në ngarkim të shtetasit *** , në Tiranë në datën 01.12.2017 rezulton se:

*“1. Arma objekt ekspertimi pa numër dhe pa stampime në trup, në ngarkim të shtetasit *** , në Tiranë në datën 01.12.2017 është pushkë me ajër e kalibrit 6 mm.*

- a) *Pushka me ajër objekt ekspertimi funksionon në bazë të parimit të ajrit të kompresuar (ngjeshur).*
 - b) *Pushka me ajër objekt ekspertimi në gjendjen që na paraqitet është e rregullt teknikisht dhe realizon qitje normale.*
- 2. Pushka me ajër objekt ekspertimi është për përdorim zbatimës, ajo përdor si municion sfera të kalibrit 6 mm.*
- 3. Pushka me ajër objekt ekspertimi nuk klasifikohet në asnjë nga kategoritë e armëve të zjarrit (luftarake, sportive dhe gjahu).*

4. *Sferat material plastik objekt ekspertimi janë të kalibrit 6 mm dhe përdoren si municion për pushkët ose pistoletat (me ajër) që funksionojnë në bazë të parimit të ajrit të komprimuar (ngjeshur)."*

Pas administrimit të akteve të ekspertimit teknik-balistik të tre pistoletave dhe pushkës të përshkruara më sipër, organi i prokurorisë ka arritur në konkluzionin se nuk ekzistojnë elementët e veprës penale "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", e parashikuar nga neni 278/5 të Kodit Penal. Për këto arsye Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën nr. 4716 prot., datë 06.04.2018 i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë pushimin e procedimit penal nr. 1814 të vitit 2017. Sipas ankuesit, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe përgjigjeve të dërguara nga DVP Tiranë me shkresën nr. 3814/1 prot., datë 11.06.2019; Komisariati i Policisë nr. 3 Tiranë me shkresën nr. 5787/1 prot., datë 27.08.2019; dhe Komisariati i Policisë nr. 4 Tiranë me shkresën nr. 3914/1 prot., datë 19.06.2019, konstatohet se veprimet e kryera nga strukturat e DVP Tiranë dhe organet e saj vartëse nuk janë në përputhje me aktet normative në fuqi dhe se informacioni i dhënë institucionit tonë nuk është korrekt dhe i saktë sepse:

1. Regjistrimi i armëve (tre pistoletave) në sistemin "SIMA" në emër të shtetasit

*** është bërë jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, datë 29.05.2015 "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, format e regjistrimit për armët për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash", i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 123, datë 23.02.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, datë 29.05.2015", respektivisht me pikën 29, gërma "c", të ndryshuar, ku parashikohet se:

"Armët pneumatike me ajër me saçma, me energji nën 7.5 J dhe armët e zjarrit për sinjalizim me dritë dhe ato me zë, blihen dhe mbahen nga personat fizikë dhe juridikë pa autorizim, me detyrimin për t'i regjistruar në Komisariatin e Policisë, brenda 5 ditëve nga data e blerjes" sepse:

a) Regjistrimi është bërë pa vullnetin e blerësit të tyre. Pavarësisht faktit që armët (tre pistoletat me ajër) të blera nga shtetasi *** konsiderohen armë në kuptimin e nenit 3/1 të ligjit nr. 74/2014, Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, datë 29.05.2015", të ndryshuar, si dhe aktit të ekspertimit teknik-balistik të cituar më sipër, kjo nuk do të thotë që regjistrimi i këtyre llojeve apo kategorive të armëve të bëhet drejtpërdrejt nga strukturat e Policisë së Shtetit sapo ato marrin dënimin për një fakt të tillë blerjeje nga subjektet fizikë apo juridikë.

E çmojmë të nevojshme të sqarojmë se, pika 29, gërma "c", e ndryshuar, e Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme të cituar më sipër, përveçse u jep të drejtë subjekteve fizikë dhe juridikë për të blerë dhe mbajtur këto armë pa autorizimin e organit kompetent, ndërkohë ajo i detyron ata që bëjnë regjistrimin e tyre në Komisariatin e Policisë brenda 5 ditëve nga data e blerjes.

Theksojmë se, nëse ankuesi, i cili është edhe pronar i tre pistoletave të përshkruara më sipër, nuk do të paraqitej për regjistrimin e tyre brenda 5 ditëve nga data e blerjes, sikurse parashikohet në pikën 29 të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, datë 29.05.2015, i ndryshuar, atëherë ndaj tij nga strukturat

përgjegjëse të Policisë së Shtetit duhet të aplikojë penaliteti i parashikuar në nenin 56, pikat 1 dhe 2/b të ligjit nr. 74/2014 “Për armët”.¹

b) Regjistrimi është bërë në kundërshtim me pikën 31, gërma “b” të këtij udhëzimi pa administruar dokumentet përkatëse dhe respektivisht atë të blerjes nga subjekti i liçencuar për tregëtim dhe letërnjoftimin e ankuesit si pronar i tyre. Mungesa e këtij dokumentacioni provohet edhe nga fakti se, ndonëse në kërkesën tonë drejtuar të tre organeve të citura më sipër kemi kërkuar informacion edhe në lidhje me dokumentacionin në bazë të cilit është bërë regjistrimi i tre pistoletave me ajër në emër të ankuesit, por ai nuk na është dërguar. Nëse nga strukturat e policisë do të ishin administruar këto dokumente, duhet të na ishte dërguar informacioni i kërkuar, si dhe fotokopja e tyre.

c) Gjithashtu ai është bërë edhe në kundërshtim me pikën 31, gërma “d” të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, datë 29.05.2015, të ndryshuar, sepse armët në fjalë nuk janë paraqitur fizikisht para specialistit të armatimit të Komisarariatit të Policisë nr. 3 ku është bërë edhe regjistrimi i tyre me qëllim për të bërë verifikimin fizik dhe e të dhënave me dokumentacionin përkatës.

2. Ndonëse sistemi “SIMA” është unik, nga DVP Tiranë dhe Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë ndërmjet të tjerave u informuam se, nga verifikimet e bëra në këtë sistem nuk rezulton që në emër të shtetasit *** të jenë regjistruar armë për të cilat ai pretendon.

Ndërkohë që nga përgjigjia e dërguar nga Komisarati i Policisë nr. 3 Tiranë rezulton se janë regjistruar tre copë pistoleta me gaz me Kod. 140001 në ngarkim të shtetasit *** Sqarojmë se nga verifikimi i bërë nga ana jonë në këtë komisarariat rezulton se këto armë janë regjistruar në emër të shtetasit *** në datën 02.05.2019. Pra, regjistrimi i tyre është bërë para datës së dërgimit të përgjigjeve nga DVP Tiranë dhe Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë.

3. Nga dokumentat e dërguara nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë së bashku me përgjigjen, respektivisht dy procesverbale “Mbi ekzekutimin e urdhrat të prokurorit për kthimin e sendeve të sekuestruara”, të mbajtuara në datat 25.04.2019 dhe 29.04.2019, rezulton se në bazë dhe në zbatim të urdhrave të ekzekutimit të organit të prokurorisë shtetasit *** i janë dhënë armët që ka blerë jashtë vendit konkretisht tre pistoleta dhe një armë tjetër me gjatësi 82 cm. Sqarojmë se këtë fakt, marrjen e tyre nga ky komisarariat, e ka pranuar edhe vetë ankuesi.

Ndërsa nga Komisarati i Policisë nr. 3 Tiranë ndërmjet të tjerave u informuam se, këto armë (tre pistoletat) janë bërë dalje nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë dhe janë bërë hyrje në Komisaratin e Policisë nr. 3 Tiranë, sipas dispozitave ligjore në fuqi, pasi ai është banor në territorin që mbulon ky komisarariat. Në fakt nga organet e policisë nuk është administruar asnjë dokument që provon se këto armë janë bërë dalje nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë dhe hyrie në Komisaratin e Policisë nr. 3 Tiranë. Armët i janë dhënë në dorëzim ankuesit *** nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë në bazë të urdhrave të ekzekutimit të organit të prokurorisë.

¹ “Kundërvajtjet administrative”

“1. Personat fizikë dhe juridikë, që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur veprimet e tyre përkatëse nuk përbëjnë vepër penale, janë përgjegjës për kundërvajtjet administrative.

2. Dënohen me gjobë prej 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë personi juridik dhe me gjobë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë personi fizik, kur:

a) e mban, e përdor armën në kundërshtim me qëllimin e caktuar në autorizimet e dhëna nga Policia e Shtetit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit;

b) nuk paraqitet në afatin e caktuar për procedurën e regjistrimit të armës së blerë, armës së koleksionit, pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit;

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës ligjore të shkelur shtetasit *** 1, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për të bërë çregjistrimin nga sistemi “SIMA” të armëve (tre pistoleta) të regjistruara në emër të shtetasit ***
2. Analizimin, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen e tij në të ardhmen.


Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi S. Nushi


11.03.20

